

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING			
Nr. Org. Org. Jedinica Org. Unit	SP-02	Nr. Prot. Broj. Prot. Prot. No.	754-2/26
Nr. i faqeve Broj. stranica No. pages	04	Data Datum Date	18.09.2026
PRISHTINE/A			



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
 Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
 Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelaria Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	10.09.2026
REFERENC-Ë:	26/754/MMPH
PËR/ZA/TO:	"Globi Metal" Sh.p.k. Lipjan, për qendrën për grumbullimin e mbeturinave metalike, plastike, presimin e tyre dhe grumbullimin e akumulatorëve mbeturinë në Banull- Lipjan
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Bajram Kafexholli, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPH-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për aprovim të Lejes Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore të operatorit "Globi Metal" Sh.p.k. Lipjan, me nr. 26/754/MMPH.

MMPH, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, vizitës në teren, mbajtjes së debatit publik me qytetar, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur.

Bashkangjitur kësaj shkrese gjeni :

- Vendimi për Leje Mjedisore për operatorin "Globi Metal" Sh.p.k. Lipjan, për qendrën për grumbullimin e mbeturinave metalike, plastike, presimin e tyre dhe grumbullimin e akumulatorëve mbeturinë në Banull- Lipjan; dhe
- Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Udhëzimi Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore i ndryshuar dhe plotësuar me Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr. 01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 26/754/MMPH
Datë: 10.09.2026


Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, nenit 12 paragrafi 1, 5 dhe 7 dhe nenin 13 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore si dhe nenit 8 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, si dhe Mendimit Profesional të Komisionit për Leje Mjedisore të dt. 24.08.2026, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Operatorit "Globi Metal" Sh.p.k. Lipjan, pajiset me Leje Mjedisore për qendrën për grumbullimin e mbeturinave metalike, plastike, presimin e tyre dhe grumbullimin e akumulatorëve mbeturinë në ngastrat kadastrale P- 71409003-00367-1, nr. P me nr. P-71409003-00367-5 në Banull- Lipjan.

2. Operatori obligohet:

- Të bëjë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve dhe të sigurojë përmbushjen e kërkesave teknike dhe mjedisore gjatë gjithë kohës së operimit;
- Të mbajë evidencë të rregullt për mbeturinat e pranuara, duke përfshirë llojin, sasinë, origjinën dhe destinimin e tyre;



- Akumulatorët mbeturinë të ruhen në sipërfaqe të betonuar, të mbuluar dhe të izoluar, në mënyrë që të parandalohet rrjedhja e substancave të rrezikshme dhe ndotja e tokës dhe ujërave;
- Mbeturinat të klasifikohen sipas llojit dhe të vendosen në hapësira të posaçëm, të përshtatshëm për secilin lloj të mbeturinës, të cilët duhet të jenë të identifikuar dhe të shënuar qartë;
- Për zbatimin e sistemit të menaxhimit mjedisor të ketë personin me profil përkatës inxhinierik, i cili do të jetë përgjegjës për çështjet e mjedisit;
- Në rast të ndonjë incidenti apo situatë tjetër gjatë operimit, e cila mund të shkaktojë ndikim negativ në mjedis ose në shëndetin e popullatës, të ndërmarrë menjëherë masat për parandalimin dhe kufizimin e ndikimit dhe ta njoftojë MMPH-në;
- Të sigurojë që mbeturinat e pranuar të mos digjen, përpunohen apo trajtohen në mënyrë tjetër nga ajo e përcaktuar me këtë Leje Mjedisore dhe legjislacionin në fuqi;
- Të sigurojë që gjatë transportit, pranimi, magazinimit dhe trajtimit të mbeturinave të ndërmerren të gjitha masat e nevojshme për parandalimin e ndotjes së tokës, ujërave, ajrit dhe rrezikimit të shëndetit të njerëzve;
- Të mbajë lokacionin dhe hapësirat e operimit të pastra dhe të rregulluara, si dhe të sigurojë menaxhimin e duhur të të gjitha mbeturinave të krijuara gjatë veprimtarisë;
- Të mirëmbahet sistemi për grumbullimin e ujërave nga sipërfaqja operationale të lidhur me pusin sedimentues;
- Të respektojë të gjitha kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në këtë Leje Mjedisore, si dhe dispozitat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e mbeturinave.

Arsyetim

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisore vizitës në terren për verifikimin e kushteve mjedisore, mbajtjes së debatit publik për operatorin "Globi Metal" Sh.p.k. Lipjan, është konstatuar se operatori për veprimtarinë: për qendrën për grumbullimin e mbeturinave metalike, plastike, presimin e tyre dhe grumbullimin e akumulatorëve mbeturinë në ngastrat kadastrale P- 71409003-00367-1, nr. P me nr. P-71409003-00367-5 në Banull-Lipjan, plotëson kriteret e parapara me Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr.04/2022 për Leje Mjedisore, si dhe Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr. 01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 04/2022.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, vlerëson se operatori i plotëson kushtet teknike dhe mjedisore dhe merr Vendim për lëshimin e Lejes Mjedisore.

Kjo Leje Mjedisore lëshohet për periudhën 5 (pesë) vjeçare, komfori nën 31 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtje e Mjedisit dhe nenit 12 paragrafi 7 të Udhëzimit



Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore i ndryshuar dhe plotësuar me nenin 8 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi.

Bajram Kafexholli

U.D i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPH-së

Vendimi i 'u dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës;
- DMM-së;
- Inspektoratit;
- Kabinetit të Ministrit
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPH-së;
- Arkivit të MMPH-së.